



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:168344

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05521127

**C.nr.2560/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Shaban Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses D.S. me numër personal ..... të cilën me autorizim e përfaqëson av, H.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Universiteti i Prizrenit “U.H.” me seli në Prizren, për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë punës dhe inflacionit të ardhurave, vlera e kontestit 2,982.00€, jashtë seancë gjyqësore, me datë 28.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**(Pa shqyrtim kryesor)**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.S. nga Prizreni, kundër të paditurës Universiteti i Prizrenit “U.H.” me seli në Prizren, për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë punës dhe inflacionit të ardhurave.
- II. DETYROHET** e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të mesatares së inflacionit për pagat e marra tek i padituri për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t’ia kompensojë paditëses shumë prej 1,436.00€ (njëmijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë euro) si dhe në emër të ushqimit gjatë punës tek i padituri për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t’ia kompensojë shumë prej 1,546.00€ (njëmijë e pesëqind e dyzetë e gjashtë euro), përkatësisht gjithsej shumë prej **2,982.00€** (dymijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy euro), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë (07.08.2023), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura, që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 144.00 €, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja D.S. nga Prizreni nëpërmjet të autorizuarës së saj av. M.B. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Univeristeti i Prizrenit “U.H.” me seli në Prizren, me objekt kontesti kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës.

Në padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe se paditësja konsideron se ka të drejtë ligjore për kompensim. Me datë 30.06.2023 të paditurës i kemi përcjellë kërkesën për kompensimin e të ardhurave që lindin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me datë 18.04.2017 dhe datë 22.01.2021, mirëpo nuk kanë

marrë përgjigje për aprovim apo refuzim të kërkesës. Kontrata kolektive përcakton të drejtat e kompensimit për arsimin universitar në bazë të së cilës i njihet e drejta e kompensimit paditëses. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Me parashtrësën e datës 23.10.2023 i autorizuari i paditëses av. H.S. ka bërë rregullimin dhe precizimin e padisë, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën Universiteti i Prizrenit "U.H." me seli në Prizren që paditëses D.S. t'ia bëjë kompensimin për mesataren e inflacionit në pagë për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 shumë prej 1,436.00€ si dhe në emër të ushqimit gjatë punës për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 t'ia kompensojë shumë prej 1,546.00€, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 2,982.00€ me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta hedhë poshtë si të pa lejuar, për faktet se dokumentet të cilat janë paraqitur nga pala paditëse nuk janë relevante dhe nuk i plotësojnë elementet e një dokumenti zyrtar, padia është parashtruar pa i shterur mjete e brendshme të universitetit, gjatë vitit 2020 dhe 2021 mësimi është mbajtur në platformat online, për shkak të COVID 19, universiteti është në vijë buxhetore e MASHT dhe nuk ka kategori financiare të ndarë për kompensimin e beneficioneve që burojnë nga kontrata kolektive, me datë 15.12.2022 me vendim që Qeverisë së RKS është shfuqizuar njëanshëm KKA në mes MASHT dhe SBASHK dhe institucioneve të arsimit në Kosovë e pas kësaj date nuk mund të bëhet asnjë kompensim apo beneficion që buron nga kjo kontratë. Shpenzime e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: vërtetimi i datës 09.10.2023 lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në pune, për vitin 2019 (63 ditë pune), për vitin 2020 (262 ditë pune), për vitin 2021 (224 ditë pune) për vitin 2022 (224 ditë pune), kontratat e punës me nr. të prot. 06-42, 04-227 dhe 06-374, vendimin me nr, të prot. 01-471, dhe vendimin me nr prot. 01-263.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga vërtetimi i datës 09.10.2023 lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në pune, paditësja ka prezantuar në punë si në vijim: për vitin 2019 (63 ditë pune), për vitin 2020 (262 ditë pune), për vitin 2021 (224 ditë pune) për vitin 2022 (224 ditë pune), nga kontratat e punës me nr. të prot. 06-42, 04-227 dhe 06-374 vërtetoi faktin se paditësja është në marrëdhënie pune pranë të paditurës si asistente dhe pagën mujore e ka 803.40€, vendimin me nr, të prot. 01-471 të njëjtës i është refuzuar kërkesa për kompensimin e obligimeve që lindin nga KKAK si dhe vendimin me nr prot. 01-263 e njëjta është përzgjedhur asistente pranë Fakultetit Juridik., andaj bazuar në lartësinë e pagës së paditëses dhe bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë

3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Në rastin në fjalë nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura Universiteti i Prizrenit “U.H.” në Prizren, por mbetet kontestues fakti se paditëses a i takon kompensimi për ushqim gjatë punës dhe inflacioni i të ardhurave, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditëses është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, konkretisht të nenit 35.7, i cili rregullon të drejtën për shujta – ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret si dhe nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

**Për mesataren e inflacionit në pagë për vitet:**

- 2022 (11.6% inflacioni) shuma nga paga bazë 803.40€ x 11,6% për një muaj 93.19€, për 11 muaj gjithsej 1,025.00€,
- 2021 (3,4% inflacionit) shuma nga paga bazë 803.40€ x 3,4% për një muaj 27.32€, për 12 muaj gjithsej 327.00€,
- 2020 (0,2% inflacionit) shuma nga paga bazë 803.40€ x 0,2% për një muaj 1.61€, për 12 muaj gjithsej 19.28€,
- 2019 (2,7% inflacionit) shuma nga paga bazë 803.40€ x 2,7% për një muaj 93.19€, për 3 muaj gjithsej 65.00€, e gjithsej shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,436.00€.

**Për kompensimin e ushqimit gjatë punës për vitet:**

- 2022 për 224 ditë pune nga 2€ në ditë gjithsej 448.00€
- 2021 për 224 ditë pune nga 2€ në ditë gjithsej 448.00€
- 2020 për 262 ditë pune nga 2€ në ditë gjithsej 524.00€

- 2019 për 63 ditë pune nga 2€ në ditë gjithsej 126.00€, e gjithsej shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,546.00€

Duke u bazuar në dispozitat materiale të lartcekura të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditëses, ashtu që e detyroi të paditurën që t'ia kompensojë ushqimin ditor në shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,546.00 € duke llogaritur një ditë pune nga 2 €, për shkak se provat materiale konkretisht vërtetimet e lëshuara nga vet e paditura vërtetohen ditët e pranisë së paditëses në punë tek e paditura, po ashtu t'ia kompensojë mesataren e inflacionit për pagat e marra tek i padituri për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 shumën e përgjithshme në lartësi prej 1,436.00€.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (07.08.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësve t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104.00 € dhe në emër të taksës për padi 40.00 €, e në shumë të përgjithshme prej 14.00€, të gjitha këto bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**  
**C.nr.2560/2023 më datë 28.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Shaban Sh. Shala**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.